



Save the Children

NËNTË KËRKESAT THEMELORE

Për pjesëmarrje kuptimplotë
dhe etike të fëmijëve



PARATHËNIE

Shtrirja e të drejtave të fëmijëve në nivel global është e pashembullt. Konventa për të Drejtat e Fëmijës është instrument për mbrojtjen e të drejtave të njeriut me një nivel pranimi pothuajse universal brenda Kombeve të Bashkuara, me përjashtim të një shteti të vetëm që ka vendosur të mos e përfshijë atë në sistemin e vet ligjor.

Ky nivel i pranimit është tregues i një vetëdijësimi që bashkësia ndërkombëtare e solli 31 vjet më parë me instrumentin e parë ligjor për të drejtat e njeriut për fëmijët.

Por sfidat me të cilat përballen fëmijët janë ende të shumta në shoqëritë tona që ata të njihen si subjekte të të drejtave.

Në kuadër të këtyre sfidave, pjesëmarrja është një nga temat kryesore.

Dëgjimi i fëmijëve ende neglizhohet nga të rriturit dhe institucionet. Në këtë kohë pandemie, ne kemi qenë dëshmitarë se si zërat e fëmijëve praktikisht nuk janë përfillur në vendimmarrje.

Fëmijët rrallë janë konsultuar për ndjenjat, frikën, pritjet dhe propozimet e tyre, gjë që tregon se sa progres mbetet ende për t'u bërë në të ardhmen.

Format dhe formatet, zakonisht të zhvilluara nga logjika dhe perspektiva e të rriturve, duhet të rimendohen në mënyrë që vajzat dhe djemtë të jenë protagonistë aktivë të shoqërive tona. Gjuha që është përshtatur me moshën dhe nivelin e tyre të zhvillimit dhe formatet e përshtatshme për fëmijët janë elemente thelbësore në mënyrë që fëmijët të mund të përfshihen në proceset shoqërore.

Për ta arritur këtë gjë, ne duhet të mësojmë dhe të çlirohemi nga paragjykimet që aktualisht bllokojnë praninë dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në shoqëritë tona.

Këta 9 hapa për pjesëmarrjen e fëmijëve na ndihmojnë në veprimet tona dhe në proceset që për qëllim kanë mbështetjen e fëmijëve duke na ndihmuar që të krijojmë mjedise që nxisin pjesëmarrjen e fëmijëve.

Ju ftoj t'i lexoni dhe t'i zbatoni në jetën e përditshme, ashtu siç duhet t'i mësojmë edhe ne. Jam i bindur, dhe këtë po na e tregojnë edhe djemtë dhe vajzat, se me pjesëmarrjen e tyre shoqëritë tona do të përfitojnë nga pikëpamjet e tyre të reja, të pashembullta dhe pa paragjykimet.

Luis Pedernera

Kryetar i Komisionit
mbi të Drejtat e Fëmijës



Save the Children

HYRJE

Pjesëmarrja e fëmijëve është një "...proces i vazhdueshëm, i cili përfshin shkëmbimin e informatave dhe dialogun ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve bazuar në respektin e ndërsjellë dhe gjatë të cilit fëmijë mund të mësojnë se si pikëpamjet e tyre dhe të të rriturve merren parasysh

1



Neni 12 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF) – e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar – është parimi themelor për pjesëmarrjen e fëmijëve (PF). Si një nga katër parimet udhëzuese të KDF-së, neni 12 është i ndërlidhur dhe i pandashëm nga të gjitha të drejtat e tjera të parashikuara me Konventë. Ka nene shtesë që në mënyrë specifike ndërlidhen me nenin 12 dhe ndihmojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e pjesëmarrjes kuptimplotë të fëmijëve. Këto të drejta civile janë përmbledhur gjerësisht nën termin "pjesëmarrje" dhe përfshijnë të drejtën e lirisë së shprehjes, mendimit, ndërgjegjes, fesë, shoqërimit, tubimit paqësor, mbrojtjes së privatësisë dhe qasjes në informata (nenet 13 – 17 të KDF-së). Për më tepër, neni 23 thekson rëndësinë e krijimit të kushteve që lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunitet dhe neni 29 inkurajon edukimin që përgatit fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë që promovon paqen, tolerancën dhe barazinë.

Save the Children beson se pjesëmarrja e fëmijëve nuk është vetëm aktivitet ose ndodhi, por një parim thelbësor mbi të cilin bazohet sjellja jonë organizative. Pjesëmarrja e fëmijëve është temë ndërsektoriale që i përshkon të gjitha aspektet e organizatës dhe është element thelbësor në synimin tonë për forcimin e pozitës së fëmijëve dhe për të nxitur përparim në mënyrën se si bota i trajton fëmijët. Pra, është një grup i të drejtave civile që duhen përmbushur, një parim që duhet zbatuar dhe një mjet që përdoret për të përmbushur të drejta të tjera. Në thelb, promovimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes së fëmijëve ka të bëjë me përmbushjen e detyrimeve për të drejtat e njeriut dhe respektimin e fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Ndërmjet viteve 2000-2006, Save the Children mbështeti pjesëmarrjen e fëmijëve gjatë dy proceseve të rëndësishme: Seanca Speciale e OKB-së për Fëmijët dhe Studimi i OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve. Fëmijët morën pjesë dhe i ndanë përvojat dhe rekomandimet e tyre në nivel komuniteti, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Pikërisht përmes këtyre proceseve e pamë një fëmijë tek i drejtohej Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për herë të parë në histori, dhe rrjedhimisht edhe ngritjen e mekanizmave kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve (me fëmijët) që ekziston edhe sot. Ishte pikërisht gjatë këtyre proceseve që Save the Children investoi kohë dhe burime për t'i vlerësuar përpjekjet tona për ta mbështetur pjesëmarrjen e fëmijëve. Duke punuar së bashku me fëmijët, u nxorën mësimet kryesore dhe në vitin 2005 Save the Children zhvilloi shtatë *Standardet e Praktikave në Pjesëmarrjen e Fëmijëve*. Në vitin 2009, duke u mbështetur në shtatë standardet tona, Komenti i Përgjithshëm mbi nenin 12 të KDF-së (CRC/C/GC/12) përfshiu nëntë *kërkesa themelore për zbatimin e të drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar*.

Nëntë kërkesat themelore për pjesëmarrje kuptimplotë dhe etike të fëmijëve shërbejnë për të siguruar pjesëmarrje cilësore të fëmijëve në 'të gjitha proceset në të cilat dëgohen dhe marrin pjesë fëmija ose fëmijët'.² Ato na ndihmojnë ta përmirësojmë cilësinë në programe, avokimin dhe fushatat tona globale. Më tej, këto kërkesa na ndihmojnë për të siguruar që zërat e fëmijëve të dëgohen dhe të respektohen dhe të japim llogari si organizatë e pavarur kryesore në botë për fëmijët.

¹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm Nr.12, E drejta e Fëmijës për t'u Dëgjuar, CRC/C/GC/12, korrik 2009, paragrafi 3.

² Po aty, parag 134,



1

PJESËMARRJE TRANSPARENTE DHE INFORMUESE



Përshkrim i shkurtër

Kërkesa e parë nënkupton që fëmijët ta kuptojnë qartë të drejtën e tyre për t'i shprehur pikëpamjet e tyre dhe se ata do të dëgjohen dhe vlerësohen. Fëmijët e dinë pse janë të përfshirë në një projekt/program/aktivitet të caktuar, se çfarë do të arrijnë me pjesëmarrjen e tyre dhe llojet e vendimeve dhe planeve në të cilat do të ndikojë me pjesëmarrjen e tyre. Fëmijët kanë qasje në informata dhe burime të dobishme në mënyrë që ta kuptojnë projektin, programin, organizatën(-at), terminologjinë kryesore dhe proceset/aktivitetet në të cilat do të përfshihen. Në veçanti, fëmijët e kuptojnë se çfarë kërkohet nga ta, çfarë do të ndodhë me informatat që i dhënë dhe kush do të ketë qasje në ato informata. Fëmijët e kuptojnë se mund të shtrojnë pyetje lirisht, të kërkojnë sqarime, të ngrënë shqetësime dhe/ose të shprehin ide dhe rekomandime.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Mundësitë dhe kufizimet përcaktohen qartë me fëmijët
- ✓ Rolet dhe përgjegjësitë e fëmijëve përcaktohen qartë
- ✓ Fëmijët e kuptojnë se si ata/komuniteti i tyre/projektet e tyre/bashkëmoshatarët e tyre mund të përfitojnë nga aktiviteti
- ✓ Informatat e përshtatshme për fëmijët ofrohen në gjuhë/formate të përshtatshme dhe të qasshme
- ✓ Informatat e përshtatshme për fëmijët ofrohen në kohën e duhur
- ✓ Fëmijët i kuptojnë qartë politikat dhe procedurat përkatëse për të siguruar pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë
- ✓ Pikëpamjet e fëmijëve do të ndikojnë, formojnë dhe shërbejnë si bazë për vendimet/planet përkatëse në kohën e duhur
- ✓ Fasilituesit janë të sqarë dhe të hapur me fëmijët
- ✓ Fasilituesit nuk i orientojnë apo manipulojnë fëmijët
- ✓ Fëmijët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe dinë se si të marrin më shumë informata, nëse dëshirojnë
- ✓ Fasilituesit përshtaten dhe reagojnë ndaj ndryshimeve/sfidave të papritura dhe eksplorojnë opsionet së bashku me fëmijët
- ✓ Zgjidhja e problemeve bëhet së bashku me fëmijët



Save the Children

2

PJESËMARRJE VULLNETARE



Përshkrim i shkurtër

Fëmijët marrin informata të mjaftueshme për t'i kuptuar zgjedhjet që u vihen në dispozicion, çfarë nënkuptojnë ato dhe si të angazhohen – ose jo, sipas rastit – me procesin. Fëmijët i kuptojnë qartë rrjedhojat e zgjedhjeve të tyre dhe janë të lirë të marrin vendime për të marrë pjesë ose jo në përputhje me rrethanat. Stafet i ka kompetencat e nevojshme për t'i inkurajuar fëmijët, e veçanërisht ata që janë të marginalizuar, të marrin pjesë dhe për të siguruar që fëmijët të mos detyrohen me force që të marrin pjesë. Fëmijët janë të vetëdijshëm se mund të tërhiqen nga procesi i pjesëmarrës në çdo kohë dhe e dinë se si ta bëjnë këtë. Një kulturë që respekton zgjedhjen e lirë të fëmijëve duhet të nxitet gjatë gjithë procesit pjesëmarrës.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Fëmijëve nuk u bëhet presion (direkt ose indirekt) për të marrë pjesë
- ✓ Fasilituesit kanë adresuar mosbalancën e pushtetit mes të rriturve/fëmijëve për të siguruar që procesi të jetë vërtet vullnetar
- ✓ Fëmijët kanë dhënë pëlqimin/pajtimin dhe janë të vetëdijshëm se si do të ndahen kontributet e tyre
- ✓ Fëmijët i kuptojnë parimet e pjesëmarrjes së fëmijëve (p.sh. këto Nëntë Kërkesa Themelore)
- ✓ Fëmijët e dinë se mund të tërhiqen në çdo kohë dhe dinë si të tërhiqen nga një proces
- ✓ Fëmijëve u sigurohet informacion dhe kohë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bërë zgjedhje të bazuara
- ✓ Fëmijët e kuptojnë se çfarë do të thonë zgjedhjet e tyre
- ✓ Fëmijët kanë njohuri të mjaftueshme për qëllimin dhe natyrën e projektit/programit/aktivitetit dhe rolin e tyre në të, ashtu që të bëjnë zgjedhje në mënyrë të vazhdueshme
- ✓ Fasilituesit kanë një politikë të qartë për pjesëmarrjen, duke përfshirë pëlqimin dhe konfidencialitetin
- ✓ Fasilituesit janë të vetëdijshëm se leja e dhënë nën presion nuk është pëlqim
- ✓ Fëmijët, fasilituesit dhe kujdestarët kanë informacione në lidhje me sfidat/rreziqet dhe procedurat e reagimit që lidhen me platformat online



3

PJESËMARRJE RESPEKTUESE



Përshkrim i shkurtër

Pikëpamjet e fëmijëve trajtohen me respekt nga të rriturit dhe nga fëmijët e tjerë. Stafi ka krijuar një kulturë organizative që u mundëson fëmijëve të japin vetë idetë dhe të shprehin pikëpamjet e tyre pa ndjenjën se duhet së pari të kërkojnë leje nga një i rritur. Pikëpamjet e fëmijëve dëgjohen dhe vlerësohen. Fëmijët mund t'i shprehin pikëpamjet e tyre pa frikë nga diskriminimi; respekti bën të mundur një kulturë që nuk i nënvlerëson fëmijët ose pikëpamjet e tyre dhe ku merren parasysh prejardhja, përvojat, shqetësimet, dobësitë dhe përkushtimi i tyre. Po kështu, trajtimi me respekt siguron që fëmijët të mos poshtërohen ose të ekspozohen ndaj dëmeve. Respekti krijon një mjedis mikpritës dhe inkurajon një qëndrim të kujdesshëm dhe të vëmendshëm ndaj fëmijëve.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Fëmijët janë në gjendje t'i shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre
- ✓ Fëmijët kanë vetbesim kur i ndajnë mendimet, idetë dhe njohuritë e tyre
- ✓ Fasilitimi efektiv siguron që fëmijët të mos poshtërohen, të mos kenë frikë të flasin ose të diskriminohen
- ✓ Fasilitimi efektiv siguron që mënyrat e punës të kenë parasysh kulturën dhe gjininë
- ✓ Angazhimet/të drejtat e tjera të fëmijëve (p.sh. shkolla/puna/loja) merren parasysh
- ✓ Fasilituesit janë të sjellshëm dhe të vëmendshëm
- ✓ Fasilituesit kanë aftësi efektive të të dëgjuarit (duke përfshirë komunikimin sy më sy dhe ndërveprimet në internet)
- ✓ Fasilituesit nuk dominojnë dialogun dhe nuk u imponojnë fëmijëve vlerat dhe opinionet e tyre
- ✓ Të rriturit (p.sh. prindërit, mësuesit) janë mbështetës
- ✓ Fasilituesit kanë njohuri të shumta të kontekstit socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor të fëmijëve me të cilët punojnë dhe përcaktojnë mbështetjen e tyre në përputhje me rrethanat.
- ✓ Dokumentet, të dhënat dhe produktet e zhvilluara nga fëmijët ruhen në mënyrë të përshtatshme
- ✓ Fëmijët nuk përdoren apo manipulohen kurrë nga të rriturit për të çuar përpara agjendën e këtyre të fundit
- ✓ Fëmijët mbështeten për të komunikuar me respekt me bashkëmoshatarët e tyre/fëmijët e tjerë
- ✓ Fëmijët e kuptojnë rëndësinë e respektimit të privatësisë dhe limiteve personale të fëmijëve të tjerë

4



PJESËMARRJE RELEVANTE

Përshkrim i shkurtër

Fëmijët janë në gjendje të kontribuojnë me ekspertizën e tyre dhe të përdorin përvojat, njohuritë dhe aftësitë e tyre që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet me rëndësi për jetën e tyre. Fëmijëve u ofrohen informata të mjaftueshme. Fëmijët e kuptojnë pse një çështje është e rëndësishme për ta dhe pse po kërkohen pikëpamjet dhe ekspertiza e tyre. Fëmijët e vlerësojnë plotësisht se si kontributi i tyre në diskutim/kërkim/konsultim/takim do të shërbejë si bazë për planet për trajtim të çështjeve të caktuara. Pritjet e fëmijëve menaxhohen në mënyrë efektive dhe ata e kuptojnë rëndësinë dhe kufizimet e pjesëmarrjes së tyre. Fëmijëve u jepet mundësia të identifikojnë probleme që ata vetë besojnë se janë relevante dhe të rëndësishme për ta.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Temat/mundësitë kanë vërtet rëndësi për fëmijët e përfshirë
- ✓ Fëmijët inkurajohen t'i identifikojnë/theksojnë problemet që ata vetë i konsiderojnë si relevante
- ✓ Fëmijët e kuptojnë qartë pse po marrin pjesë në një diskutim/hulumtim/konsultim/proces të caktuar
- ✓ Fëmijët e kuptojnë se si kontributi i tyre do t'i shtojë vlerë procesit
- ✓ Fasilitimi efektiv u mundëson të gjithë fëmijëve të përfshihen në proces dhe aktivitete
- ✓ Faktorët kulturorë merren parasysh me kujdes gjatë procesit të planifikimit
- ✓ Fëmijët përfshihen duke i kushtuar rëndësi moshës, aftësisë, kapacitetit dhe rrethanave të tyre
- ✓ Aspektet gjuhësore merren parasysh dhe merren veprime për t'i zgjidhur pengesat e komunikimit
- ✓ Fëmijët e kanë të qartë se çfarë mundën dhe çfarë nuk mundën të ndikojnë; pritjet e tyre menaxhohen në mënyrë efektive
- ✓ Çdo ndryshim i papritur në një program/proces u komunikohet fëmijëve me kujdes
- ✓ Fëmijët kanë qasje në informacione të mira, të përshtatshme për fëmijët, në mënyrë që të mund të përcaktojnë në mënyrë efektive se si duan të marrin pjesë, si dhe për problemet që kanë më shumë rëndësi
- ✓ Metodatat e angazhimit dhe opsionet që lidhen me ndarjen e informacionit/pjesëmarrjen në distancë eksplorojnë së bashku me fëmijët dhe rishikohen/përshtaten sipas nevojës



5

PJESËMARRJE MIQSORE PËR FËMIJË



Përshkrim i shkurtër

Fëmijët ndihen të mirëpritur. Stafi është i afërt dhe i përgjegjshëm ndaj fëmijëve. Metodatat e punës nuk i diskriminojnë fëmijët, por merren parasysh kapacitetet e tyre në zhvillim e sipër, moshën, diversitetin dhe aftësitë e tyre. Fëmijët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të ngrenë shqetësime. Metodatat e përdorura rrisin vetbesimin e fëmijëve për të folur, shkëmbyer dhe shprehur pikëpamjet e tyre. Koha, informacioni dhe materialet e mjaftueshme u ofrohen dhe komunikohen në mënyrë efektive fëmijëve për të ndihmuar në lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre kuptimplotë. Fëmijët e shohin se kontributet e tyre do të vlerësohen dhe përdoren për qëllimet e caktuara.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Metodatat/qasjet janë miqsore për fëmijët
- ✓ Vendet dhe oraret e takimeve janë të përshtatme për fëmijët dhe të qasshme nga ta
- ✓ Fëmijëve dhe prindit/kujdestarit të tyre u jepen paraprakisht informacione përkatëse dhe të përshtatshme për fëmijët
- ✓ Merret pëlqimi përpara se të zhvillohet ngjarja, takimi ose aktiviteti
- ✓ Fëmijët zhvillojnë ose bashkë-zhvillojnë materiale dhe metoda të informimit dhe komunikimit të përshtatshëm për ta
- ✓ Fasilituesit kanë aftësitë e nevojshme për t'i bërë fëmijët të ndihen të relaksuar dhe të ndërtojnë vetëbesimin e tyre
- ✓ Fasilituesit janë efektivë dhe kanë njohuri për një gamë të gjerë metodash të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët
- ✓ Fasilituesit janë të adaptueshëm dhe fleksibil në qasjen e tyre
- ✓ Është caktuar kohë e mjaftueshme për aktivitetet e propozuara
- ✓ Janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për t'i bërë hapësirat/platformat të qasshme për të gjithë fëmijët, duke përfshirë edhe më të margjinalizuarit.
- ✓ Fëmijët marrin udhëzime të lehta për t'u ndjekur për qasje/përdorim të platformave në distancë/online
- ✓ Fëmijët ndihmojnë në përcaktimin e mjedisit/platformës që do të funksionojë më mirë për ta
- ✓ Fëmijët dhe fasilituesit vlerësojnë vazhdimisht se si funksionojnë mjediset/platformat dhe bëjnë përshtatje sipas nevojës





PJESËMARRJE GJITHËPËRFSHIRËSE

Përshkrim i shkurtër

Duke promovuar faktin se fëmijët nuk i përkasin të gjithë një grupi homogjen, pjesëmarrja e tyre promovon gjithëpërfshirjen dhe e trajton çdo fëmijë si individ. Asnjë fëmijë nuk diskriminohet gjatë procesit të pjesëmarrjes. Gjatë procesit të pjesëmarrjes merren parasysh modelet ekzistuese të diskriminimit, disbalancat e pushtetit dhe ndjeshmëritë kulturore. Procesit siguron që metodat, qasjet, gjuhët dhe përshtatjet ashtu që të mos përjashtojnë fëmijët më të marginalizuar. Procesit nuk i diskriminon fëmijët në bazë të aftësive të tyre; nuk i poshtëron fëmijët për asnjë arsye. Procesit i pjesëmarrjes siguron që çdo fëmijë të dijë se është i vlerësuar, i respektuar dhe i rëndësishëm.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Fëmijët nuk diskriminohen për shkak të moshës, gjinisë, racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionëve politike ose të tjera, origjinës kombëtare, etnike ose sociale, pronës, aftësisë së kufizuar, lindjes ose ndonjë statusi tjetër
- ✓ Angazhohen fëmijët e të gjitha gjinive, moshave, prejardhjeve dhe aftësive
- ✓ Ofrohet një hapësirë e sigurt për grupe të ndryshme fëmijësh për të eksploruar çështje të rëndësishme për ta (p.sh. vajzat punojnë veçmas nga djemtë, nëse është e nevojshme)
- ✓ Procesit siguron që fëmijët më të prekur nga diskriminimi dhe pabarazia të kenë qasje të barabartë dhe që zëri i tyre të dëgjohet dhe vlerësohet
- ✓ Pjesëmarrja është mjaft fleksibile duke iu përgjigjur nevojave, pritjeve dhe situatave të fëmijëve si individë
- ✓ Pjesëmarrja i sfidon dhe i përgjigjet modeleve ekzistuese të diskriminimit
- ✓ Metodatat dhe teknikat e fasilimitit nuk i diskriminojnë fëmijët, janë të qasshme dhe promovojnë qasje të barabartë
- ✓ Janë bërë përpjekje të drejtpërdrejta për t'u takuar në mjedise dhe kohë të përshtatshme për fëmijët, veçanërisht për më të marginalizuarit, duke marrë parasysh kërkesat specifike (p.sh., transporti dhe mjediset e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara)
- ✓ Fëmijët përfshihen në zgjidhjen e problemeve dhe eksplorimin e opsioneve kreative për të siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse
- ✓ Janë eksploruar/formuar partneritete me personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tyre përfaqësuese për të përcaktuar një strategji të mirë pjesëmarrjeje
- ✓ Informacioni i përshtatshëm për fëmijët është i qasshëm dhe përfshin audio, shkronja të shtypit, fotografi dhe gjuhën e shenjave
- ✓ Të gjitha përpjekjet për t'u konsultuar me fëmijët duhet të arrijnë tek më të marginalizuarit, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, grupet minoritare, vajzat, etj.



7

PJESËMARRJE ME MBËSHTETJE PËRMES TRAJNIMEVE



Përshkrim i shkurtër

Të gjithë fasilituesit që punojnë me fëmijët janë të trajnuar dhe pajisur për të punuar në mënyrë efektive me fëmijët. Në veçanti, fasilituesit që punojnë me fëmijët zotërojnë aftësi të shkëlqyera komunikimi, aftësi fasilitimi dhe aftësi analitike. Fëmijët kanë qasje në trajnime për të drejtat e fëmijëve, avokimin, komunikimin me mediat, llogaridhënien nga vendimmarrësit, angazhimin në takime, lehtësimin dhe hartimin dhe ofrimin e trajnimeve.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Të gjithë fasilituesit që ndërveprojnë me fëmijët kanë vetbesimin, aftësitë dhe mbështetjen për t'i lehtësuar proceset kuptimplota të pjesëmarrjes së fëmijëve
- ✓ Të gjithë fasilituesit që ndërveprojnë me fëmijët i kuptojnë këto nëntë kërkesa themelore dhe e kuptojnë pse pjesëmarrja është e rëndësishme
- ✓ Hartohen plane mësimore dhe zhvillimore për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes cilësore të fëmijëve
- ✓ Ekziston një gamë e larmishme mundësish formale dhe joformale për të lehtësuar mësimnxënien, njohuritë dhe zhvillimin e aftësive teknike
- ✓ Fasilituesit i kanë kushtuar kohë dhe kanë pasur qasje në dokumentet kryesore dhe burimet përkatëse
- ✓ Fëmijët kanë qasje në trajnime të përshtatshme dhe përkatëse
- ✓ Fëmijët bashkë-fasilitojnë trajnimin (kur është e përshtatshme/e mundur)
- ✓ Fëmijët kanë qasje në informacione, burime dhe personel përkatës për t'i avancuar njohuritë dhe ekspertizën e tyre
- ✓ Fasilituesit e dinë se si duket manipulimi i fëmijëve dhe marrin masa parandaluese për t'u mbrojtur nga kjo
- ✓ Marrëdhëniet ndërmjet fasilituesve/personave mbështetës janë pozitive dhe ata e trajtojnë njëri-tjetrin me respekt dhe ndershmëri
- ✓ Fasilituesit mund t'i përdorin në mënyrë efektive platformat e mësimin në distance/online për të siguruar që ndërveprimet e tyre me fëmijët të jenë të respektueshme, të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse
- ✓ Hartohen plane mësimore dhe vlerësuese për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në hapësirat/platformat e pjesëmarrjes së fëmijëve
- ✓ Fasilituesit mund t'i identifikojnë dhe t'i zbusin rreziqet që lidhen me pjesëmarrjen (përfshirë platformat e mësimin në distancë/online) së bashku me fëmijët



PJESËMARRJE E SIGURT DHE E KUJDESSHME NDAJ RREZIQEVE



Përshkrim i shkurtër

Fëmijët e dinë se janë marrë parasysh të gjitha aspektet në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e tyre nga dëmtimi. Stafi ka përgjegjësi ndaj fëmijëve me të cilët punon. Stafi duhet të marrë çdo masë paraprake për të minimizuar rrezikun nga abuzimi dhe shfrytëzimi ose çdo pasojë tjetër negative e pjesëmarrjes së fëmijëve. Është e nevojshme të sigurohet që rreziqet e mundshme të identifikohen paraprakisht. Duhet të hartohen plane të qarta të "menaxhimit të rrezikut" për të siguruar pjesëmarrjen e sigurt të fëmijëve. Politikat dhe procedurat përkatëse organizative kuptohen nga stafi dhe zbatohen në mënyrë efektive. Pritshmëritë e pjesëmarrjes menaxhohen dhe komunikohen në mënyrë efektive midis stafit dhe komuniteteve, prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve. Këto pritshmëri përcaktojnë qartë përfitimet, kufizimet dhe rreziqet e mundshme me pjesëmarrjen.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Fëmijët janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe dinë të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje kur është e nevojshme
- ✓ Janë zbatuar parimet 'mos bëj dëm' dhe 'në interesin më të mirë të fëmijës'
- ✓ Janë ndërmarrë vlerësime të parandalimit të konfliktit dhe rrezikut
- ✓ Fëmijët e përfshirë në proceset pjesëmarrëse janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për të qenë të sigurt nga abuzimi dhe dinë se ku të drejtohen për ndihmë nëse është e nevojshme
- ✓ Zhvillohen plane për mbrojtjen e fëmijëve për t'i minimizuar rreziqet, për ta parandaluar abuzimin dhe për t'i hequr barrierat me të cilat përballen disa fëmijë kur marrin ndihmë
- ✓ Krijohet sistemi i referimit për mbështetje psikosociale (ose mbështetje tjetër urgjente) për fëmijët nëse është e nevojshme
- ✓ Fëmijët përfshihen në identifikimin e rreziqeve dhe krijimin e zgjidhjeve; fëmijët ndihen të sigurt kur marrin pjesë
- ✓ Fasilituesit i dinë përgjegjësitë e tyre ligjore dhe etike në përputhje me kodet e sjelljes, politikat dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve
- ✓ Krijohet një procedurë për t'i lejuar fëmijët e përfshirë në aktivitete pjesëmarrëse të japin komente në mirëbesim
- ✓ Merret pëlqimi për përdorimin e të gjitha informatave të dhëna nga fëmijët dhe informacioni i identifikuar si konfidencial ruhet në çdo kohë
- ✓ Asnjë fotografi, video ose imazh digjital i një fëmije nuk mund të merret ose publikohet për përdorim specifik pa pëlqimin e qartë të fëmijës dhe prindit/kujdestarit.
- ✓ Detyrimet në lidhje me përgjegjësinë, sigurinë, udhëtimin dhe sigurimin mjekësor janë të deleguara qartë dhe të planifikuara në mënyrë efektive
- ✓ Caktohen rregullat bazë me fëmijët për mënyra të sigurta dhe të respektueshme për ndërveprim (përfshirë ndërveprimet në internet dhe ndërveprimet me bashkëmoshatarë)
- ✓ Ekziston një marrëveshje se si informacionet personale, videot dhe fotot do të ndahen (ose jo) për të mbrojtur sigurinë dhe privatësinë e të gjithëve
- ✓ Fëmijët dhe prindërit/kujdestarët kanë informacione në lidhje me sigurinë në internet



9

PJESËMARRJE LLOGARIDHËNËSE



Përshkrim i shkurtër

Fëmijët marrin komente se si kontributi i tyre ka shërbyer për këshillim, informim dhe ndikim në zhvillimet përkatëse deri më sot. Pjesëmarrja nuk është një ngjarje e vetme dhe proceset e llogaridhënies integrohen gjatë gjithë përpjekjeve tona për t'i marrë pikëpamjet dhe shqetësimet e fëmijëve: prandaj, sfidoni veprimet, ndikoni në rekomandime dhe siguroni përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Fëmijët kanë qasje tek akterët kryesorë dhe kanë mundësi të bëjnë pyetje dhe të japin komente për pjesëmarrjen e tyre. Mësimet e nxjerra dokumentohen sistematikisht dhe zbatohen për të siguruar përmirësimin e cilësisë. Fëmijëve u jepen komente në kohë të duhur. Fëmijët kanë kohë, mbështetje dhe informata të duhura në mënyrë që të shkëmbejnë komente me bashkëmoshatarët e tyre, veçanërisht kur emërohen nga bashkëmoshatarët e tyre dhe/ose komuniteti për t'i përfaqësuar pikëpamjet e tyre.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- ✓ Janë zhvilluar procese rigoroze monitorimi dhe vlerësimi me fëmijët
- ✓ Janë përcaktuar mekanizmat e komunikimit dhe përcjelljes me fëmijët
- ✓ Fëmijët i shohin rezultatet e pjesëmarrjes së tyre
- ✓ Planifikimi/politika/vendimet ndikohen nga fëmijët dhe proceset mësimore
- ✓ Pjesëmarrja e fëmijëve mbështetet në mekanizmat e llogaridhënies
- ✓ Të gjithë fëmijët kanë një sërë mundësish dhe procesesh për t'i dhënë komentet e tyre (jo vetëm ata fëmijë që marrin pjesë në konsultime dhe ngjarje)
- ✓ Fëmijët marrin përgjigje të përshtatshme, të ndershme dhe transparente për kërkesat, shqetësimet dhe pyetjet e tyre
- ✓ Zhvillohen versione të përshtatshme për fëmijë të çdo raporti/vlerësimi përfundimtar – fëmijët eksplorojnë se si informacioni mund të përdoret për të mbështetur veprimet e tyre/proceset vijuese
- ✓ Mekanizmat e komentimit janë pjesë e çdo procesi (përfshirë platformat në internet/në distancë)
- ✓ Çdo ndërveprim me fëmijët respekton të drejtën e tyre për të pasur informacione dhe për të ndërmarrë veprime; ne kurrë nuk i shfrytëzojmë fëmijët vetëm si burim informacioni.



DIAGRAMI I PLANIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT PËR REFERIM TË SHPEJTË

9 Kërkesat themelore – Sigurimi i cilësisë

Kërkesa	A është përmbushur Kërkesa?
<p>1) Pjesëmarrja është transparente dhe informuese</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• Të ofruar informacione të përshtatshme për fëmijët në gjuhë/formate të përshtatshme dhe të qasshme• Të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë, mundësitë dhe kufizimet	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>2) Pjesëmarrja është vullnetare</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• T'u siguruar që fëmijët të kenë kohë për të marrë një vendim të bazuar në lidhje me përfshirjen e tyre• T'u siguruar që fëmijët të tërhiqen në çdo kohë• Të adresuar disbalancën e pushtetit ndërmjet të rriturve/fëmijëve për të siguruar që procesi të jetë vërtet vullnetar	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>3) Pjesëmarrja është e respektueshme</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• të marrë parasysh angazhimet/të drejtat e tjera të fëmijëve (p.sh. shkolla/puna/loja)• t'u siguruar që praktikatat e punës të kenë parasysh aspektet e kulturës dhe gjinisë• që të rriturit (prindërit, mësuesit, etj.) të janë mbështetës dhe të informuar	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>4) Pjesëmarrja është relevante</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• t'u siguruar që çështjet të jenë relevante për fëmijët• mbështetje të iniciativave dhe temave të përcaktuara nga fëmijët• t'u siguruar që të rriturit të mos u bëjnë presion fëmijëve	<p>Shënime dhe reflektime:</p>



9 Kërkesat themelore – Sigurimi i cilësisë

Kërkesa	A është përmbushur Kërkesa?
<p>5) Pjesëmarrja është e përshtatshme për fëmijët</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• përdorim të metodave dhe qasjeve të përshtatshme për fëmijët• t'u siguruar që vendet e takimit të jenë të përshtatshme dhe të qasshme për fëmijët	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>6) Pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• angazhim të fëmijëve të gjinive, moshave, prejardhjeve dhe aftësive të ndryshme• të ofruar hapësirë të sigurt për grupe të ndryshme fëmijësh për të eksploruar çështje të rëndësishme për ta (p.sh. vajzat punojnë veçmas nga djemtë, nëse është e nevojshme)• të siguruar që procesi të jetë jodiskriminues dhe gjithëpërfshirës• të siguruar që ata që janë më të prekur nga diskriminimi dhe pabarazia të kenë qasje të barabartë• të siguruar se metodat dhe mjetet janë të qasshme dhe të promovohet qasje e barabartë	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>7) Pjesëmarrja mbështetet nga trajnimi</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• të siguruar që stafi dhe partnerët të kenë besimin dhe aftësitë për të lehtësuar proceset e PF	<p>Shënime dhe reflektime:</p>
<p>8) Participation is safe and sensitive to risk</p> <p><i>Përpyjekjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• të ndërmarrë vlerësime të ndjeshmërisë ndaj konfliktit dhe rrezikut• të zhvilluar një plan për mbrojtjen e fëmijëve• t'u siguruar që të gjithë fëmijët të dinë se ku të drejtohen për ndihmë nëse është e nevojshme	<p>Shënime dhe reflektime:</p>

9 Kërkesat themelore – Sigurimi i cilësisë

Kërkesa	A është përmbushur Kërkesa?
<p>9) Pjesëmarrja është llogaridhënëse</p> <p><i>Përpyqjet e demonstruara për:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• të zhvilluar një strategji monitorimi dhe vlerësimi (M&V).• të angazhuar fëmijët në proceset e M dhe V• të përcaktuar mekanizmat e komunikimit dhe ndjekjes me fëmijët• të siguruar që fëmijët të shohin rezultatet e pjesëmarrjes së tyre	<p>Shënime dhe reflektime:</p>

Shënime, rekomandime dhe përfundime:



Save the Children

REFERENCAT

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm nr. 12, E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar, CRC/C/GC/12, korrik 2009.

<https://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/AdvanceVersions/CRC-C-GC-12.pdf>

Save the Children (2005) *Standardet praktike në pjesëmarrjen e fëmijëve*, Save the Children UK në emër të Aleancës Ndërkombëtare të Save the Children, Londër.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 1989

<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

